

## Universiteti i Elbasani organizon Kampionatin e Volejbollit midis Ekipeve të Klubit Studentor të Sportit, Këshillit Studentor dhe personelit administrativ të universitetit

Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", organizoi në bashkëpunim me Këshillin Studentor dhe Klubin Studentor të Sportit kampionatin e volejbollit , i cili u zhvillua midis ekipeve të krijuara nga anëtarët e këtij klubi dhe personelit administrativ në Pallatin e Sportit "Tomorr Sinani".

Ky aktivitet dhe shumë të tjera të inicuar nga Këshilli Studentor dhe Klubet Studentore të Universitetit të Elbasanit, kanë si synim të kontribuojnë në ndërtimin e një komuniteti të fortë dhe të bashkuar studentësh.



